




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 21.07.20 Ref.: 977/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

V E N D I M

- I. Nuk riakreditohet Kolegji "Fama" në nivel institucional.
- II. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Kolegjit Fama për vitin akademik 2019 – 2020.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsy etimi

I. Kolegji "Fama" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional. AKA ka organizuar vlerësimin me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin "Fama", me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional. Vlerësimi për riakreditim institucional është realizuar me 19.05.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Melita Kovacevic, Magdalena Platis dhe Oana Sarbu.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit "Fama" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vlerësimit, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Kolegji "Fama" përmbush vetëm pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin

e Akreditimit. Nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se Kolegji “Fama” i plotëson substancialisht dy (2) (Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Burimet dhe hapësirat), pjesërisht gjashtë (6) (Misioni publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi; Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Mësimdhënia dhe të nxënit; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Bashkëpunimi institucional) ndërsa nuk plotëson tre (3) (Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit; Menaxhimi i cilësisë; Hulumtimi).

Sa i përket kapitullit “Misioni publik dhe objektivat institucionale”, ekipi i ekspertëve ka konstatuar se mënyra se si është definuar dhe pastaj elaboruar misioni nuk paraqet një udhëzues të qartë për planifikim strategjik si dhe nuk është i reflektuar qartë as në nivelin strukturor e as në atë operacional. Objektivat e paraqitura nuk mundësojnë një ndarje të qartë në mes të objektiveve afatmesme dhe afatgjata si dhe nuk janë plotësisht në përputhje me misionin. Pos kësaj ekspertët kanë gjetur se në elaboratin e misionit të institucionit, kolegji e vendose në rend të parë zhvillimin shkencorë përmes një procesi të jashtëzakonshëm kërkimor, gjë që nuk është në linjë me formatin e institucionit, ku edukimi do të duhej të ishte prioritet. Përveç kësaj, ekspertët kanë konstatuar se është vështirë të pritët që kolegji Fama të ketë zhvillim të jashtëzakonshëm në fushën e kërkimeve shkencore kur kemi parasysh kapacitetin e përgjithshëm të institucionit dhe performancën e tij në komponentin kërkimor.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi”, ekipi i ekspertëve ka deklaruar se Kolegji Fama ka të zhvilluar një strategji për periudhë pesë vjeçare (2018-2023). Lidhur me strategjinë ekspertët ndërkombëtar të akreditimit kanë gjetur se objektivat janë shumë të përgjithësuara dhe në analizën e monitorimit pjesa më e madhe e aktiviteteve janë ose në proces ose nuk kanë filluar të zbatohen ende, ani pse ky është viti i tretë i implementimit të strategjisë. Pos kësaj ekspertët kanë konstatuar se strategjia është e fokusuar në vlerësim e jo në monitorim, dhe për aktivitetet e shtrira në periudhën kohore 2018-2023 raportet thonë se *ende nuk është bërë vlerësimi*. Një qasje e tillë e bënë të pamundur ndërmarrjen e ndryshimeve dhe përshtatjeve të nevojshme, gjë që do të duhej të ishte roli primar i procesit të monitorimit. Në kuadër të këtij kapitulli të standardeve ekipi i ekspertëve ka konstatuar gjithashtu se strategjia e institucionit nuk reflekton plotësisht realitetin, duke mos marr parasysh kontekstin e brendshëm dhe të jashtëm, gjë që mund ta pengojë zhvillimin e institucionit. Sipas ekspertëve, informatat e ofruara në raportin e vetvlerësimit dhe në shtojca në njërin anë dhe informatat e marra gjatë intervistave nuk përputhen në shumë raste. Kolegji ka të themeluara disa njësi administrative dhe zyra mirëpo nuk është e qartë dhe transparente se kush punon në to, a janë personat e angazhuar në ato njësi me orar të plotë apo të pjesshëm, a është stafi akademik në të njëjtën kohë i angazhuar me orar të plotë edhe në punë administrative, etj. Pos kësaj, ekspertët kanë vërejtur se mungon përshkrimi i detajuar i detyrave për pozita të ndryshme si dhe nuk ka kritere të qarta të përzgjedhjes së stafit. Institucioni ka deklaruar se shpalljet për angazhim të stafit akademik bëhen zakonisht çdo semestër, e nganjëherë edhe më shpesh nëse është e nevojshme. Sipas ekspertëve kjo është e pazakontë dhe është indikacion për mungesë të stabilitetit institucionit përkitazi me stafin me orar të plotë dhe me orare të pjesshëm.

Gjatë intervistave ekipi i ekspertëve nuk ka arritur të marrin informata konsistente dhe të besueshme lidhur me stafin, veçanërisht për stafin administrativ.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit” ekipi i ekspertëve të akreditimit, ndër të tjera, ka konstatuar se zyra e re e themeluar nga institucioni për monitorim të planit strategjik nuk është pjesë e organogramit. Gjatë intervistave është përmendur se koncepti Zyrë nuk ka të bëjë me hapësirë fizike por nënkupton një organ të krijuar brenda kolegjit. Pos kësaj, kjo zyre është pjesë e buxhetit me një shumë të alokuar e cila ka një rritje të madhe në periudhën 2020-2023. Pasi që kjo nuk është hapësirë fizike (dhe nuk është pjesë e organogramit), këto shpenzime nuk kanë një destinacion të qartë, pasi që pagat dhe pajisjet janë kategori tjera.

Po ashtu ekspertët kanë vërejtur se në pjesën e të hyrave dhe shpenzimeve, janë dhënë disa elemente sa i përket shpenzimeve, kurse sa i përket të hyrave nuk ka asnjë përshkrim. Duke u nisur nga kjo, ekspertët e akreditimit besojnë se pjesa më e madhe e të hyrave bazohen në pagesat e studentëve. Në këtë rast institucioni nuk mund të demonstrojë se posedon resurse të mjaftueshme financiare për të arritur misionin dhe objektivat e paraqitura në planin strategjik. Pos kësaj ekspertët kanë vërejtur se nuk ekzistojnë objektiva të matshme që gjenerojnë nga deklaratat e misionit, prandaj rrjedhimisht nuk ekzistojnë lidhje ndërmjet objektivave dhe resurseve.

Pas vitit 2020 institucioni nuk ka të planifikuar përfitim nga fondet Erasmus, fondet kërkimore apo burime tjera të të hyrave, përveç pagesave të studentëve. Në këto kushte dhe bazuar në dokumentet e ofruara nga institucioni, ekipi i ekspertëve konstaton se Kolegji fama nuk ka buxhet realist.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike”, në raportin e vetëvlerësimit kolegji Fama ka theksuar se është miratuar një rregullore e re për zbatimin e Kodit të ri të Etikës. Ekipi i ekspertëve konsideron se kjo deklaratë nuk ka efekt të qartë pasi që ajo nuk është e publikuar në asnjërin prej dy uebfaqeve që ka në dispozicion kolegji. Pos kësaj “Udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës”, nuk adreson në mënyrë të qartë çështjet etike siç janë plagjiarizmi dhe sjellja e studentëve. Pas analizimit të planit strategjik, planifikimit të buxhetit dhe objektivave të paraqitura në RVV, ekspertët janë shprehur se vërehet mungesë e interesit të institucionit të zbatojë parimet etike dhe të alokojë mjete të mjaftueshme për këtë gjë. Për këtë arsye, ekipi i ekspertëve konstaton se institucioni ende nuk ka zbatuar kodin e etikës me procese dhe mekanizma të qartë, në aktivitetet mësimore, kërkimore, apo në proceset administrative e menaxheriale. Pos kësaj ekspertët konstatojnë se kolegji Fama ka edhe shumë punë për të bërë për të vënë në dispozicion të gjitha rregulloret e brendshme, procedurat, RVV-të, vendimet e organeve udhëheqëse etj. Në këtë fazë shumë pakë informata janë të qasshme për publikun.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Menaxhimi i cilësisë”, ekspertët kanë deklaruar se megjithëse kolegji Fama ka të miratuar Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë e cila sipas RVV-së përcakton rolet dhe përgjegjësitë e komisionit për sigurimin e cilësisë, nuk përmenden mekanizma, instrumente dhe procedura për mbledhjen e të dhënave për këtë qëllim. Po ashtu, ekipi i ekspertëve ka konstatuar se është e vështirë të kuptohet qartë se cili është roli i komisionit dhe si janë të ndara përgjegjësitë në mes të Zyrës për Sigurim të Cilësisë dhe Komisionit për Sigurimin e Cilësisë. Në uebfaqen e Kolegjit Fama ekspertët e akreditimit kanë vërejtur se Rregullorja për sigurimin e cilësisë është miratuar në vitin 2008, dhe përderisa RVV përmend si udhëzues për proceset e sigurimit të cilësisë Standardet dhe Udhëzuesit Evropian (ESG) 2015 dhe manualin e Akreditimit të AKA-së, është e vështirë të besohet që këto direktiva të reja nuk kanë paraqitur kërkesë për ndryshime në rregulloret e brendshme të institucionit. Ekspertët

kanë shtuar se roli dhe përgjegjësitë e Komisionit për Sigurimin e Cilësisë si dhe marrëdhëniet e tij me njësitë tjera administrative dhe për planifikim nuk janë të përcaktuara qartë.

Sa i përket resurseve të dedikuara për sigurim të cilësisë, drejtori i zyrës për sigurim të cilësisë është prezantuar edhe si staf akademik me orar të plotë. Ekspertët kanë konstatuar se në dy vitet e fundit, stafi i përfshirë drejtpërsëdrejti në proceset e sigurimit të cilësisë nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim apo ngjarje tjetër të ngjashme që ka të bëjë me sigurimin e cilësisë.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar nuk ka gjetur asnjë dëshmi që kolegji zhvillon sistemin e vet të sigurimit të cilësisë në mënyrë që të mirëmbajë cilësinë e aktiviteteve të tij. Sistemi për sigurimin e brendshëm të cilësisë nuk është i integruar në aktivitetet e përditshme të kolegjit, por përkundrazi duket se paraqitet vetëm për të përmbushur standardet e AKA-së.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Mësimdhënia dhe të nxëniti” ekspertët në raportin e vlerësimit kanë deklaruar se sa i përket sigurimit të cilësisë, kolegji Fama nuk ka tregues të qartë të performancës në bazë të të cilëve institucioni do të zhvillonte një sistem të brendshëm për ndryshime të rregullta dhe efikase në nivel të kurrikulës, në nivel të standardeve mësimore dhe të shkathtësive, në nivel të mësimdhënies dhe vlerësimit etj.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Hulumtimi”, në raportin e vlerësimit ekspertët kanë theksuar se institucioni nuk ka paraqitur një plan të hulumtimit në nivel institucional, por vetëm plane individuale. Në mungesë të një plani të hulumtimit të definuar mirë, është e pamundur të bëhen dhe zbatohen alokime buxhetore të qarta dhe transparente.

Në raportin e vlerësimit ekipi i ekspertëve të akreditimit ka deklaruar se kolegji Fama nuk ofron dëshmi se posedon resurse të mjaftueshme për të kryer hulumtime të cilësisë së lartë, sidomos hulumtime të nivelit të paraqitur në dokumentet e prezantuara. Pos kësaj, duke qenë se mungon një plan për zhvillim të hulumtimit shkencorë, është e pamundur të bëhet krahasimi i elementeve të planit të hulumtimit me resurset përkatëse dhe të identifikohen qartë përparësitë dhe mangësitë në këtë fushë.

Sipas ekipit të ekspertëve, megjithëse në RVV kolegji ka deklaruar se stafi akademik i kolegjit Fama ka zbatuar më shumë se 400 projekte hulumtimi, në anekset përkatëse është ofruar një listë me 42 tema të hulumtimit të ndara në 4 fusha. Për më tepër temat e paraqitura në listë nuk plotësojnë kriteret ndërkombëtare se çfarë është një projekt hulumtimi (*research project*).

Një konstatim të ngjashëm ekspertët kanë arritur edhe sa i përket publikimeve. Lista e publikimeve e dërguar me dokumente shtesë është larg standardeve të citimit të publikimeve, është krejtësisht jotransparente dhe joprofessionale.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse”, ekipi i ekspertëve të akreditimit ka deklaruar se nuk ka arritur të identifikojë një program të qartë për orientimin e studentëve të rinj që regjistrohen në kolegjin Fama.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Bashkëpunimi institucional”, ekspertët kanë konstatuar se kolegji nuk ka një strategji për bashkëpunim institucional dhe/ose internacionalizim, por se elemente të kësaj fushe janë pjesë e Planit Strategjik 2018-2023. Kolegji Fama ka një plan të veprimit të cilin ekipi i ekspertëve të akreditimit e konsideron jofunksional në kuptimin e monitorimit të zbatimit të tij. Ekspertët vënë theksin kryesisht në mungesën e treguesve të qartë dhe afateve kohore përmes të cilëve do të

matej arritshmëria e aktiviteteve të caktuara. Për më tepër, në listën e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë vendorë dhe ndërkombëtar të paraqitur nga kolegji Fama në raportin e vet-vlerësimit, ekipi i ekspertëve ka vërejtur se lista përmban universitete që janë mbyllur para 5 viteve.

Në kuadër të këtij kapitulli të standardeve ekspertët kanë konstatuar se numri i mobiliteteve të studentëve dhe stafit akademik është shumë i vogël, dhe se angazhimi në bashkëpunime ndërkombëtare dhe kontributi në komunitet nuk janë në mesin e kritereve për avancim dhe për vlerësim të stafit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shkollësor të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "Fama"
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.